



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORATI

Nr. 209 prot

Durrës, më 11. 2. 2021

VENDIM

Nr. 4 datë 11. 2. 2021

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë", të VKM.658, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit dhe Rregullores UAMD, Rektorati në mbledhjen e datës 11.02.2021,

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve të vënë në dispozicion të studentëve listën e lëndëve provimet e të cilave do të zhvillohen në auditor për shkak të specifikës së tyre, informacioni të përcillet brenda datës 12.02.2021 në Rektorat;
2. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve të paraqesin grafikun për mënyrën e zhvillimit të provimeve, duke patur në konsideratë specifikën në një klasë jo më shumë se 14 studentë, informacioni të përcillet brenda datës 15.02.2021 në Rektorat;
3. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve të njoftojnë stafin akademik që studentët nuk do të penalizohen për mungesa. Për studentët të cilët nuk kanë mundësi pjesëmarrje në provim, do të caktohet një datë e dytë për zhvillimin e provimeve gjatë muajve maj, qershor;
4. Propozim Senatit Akademik për heqjen e lëndëve të parakërkuara për vitin akademik 2020-2021;
5. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve, Përgjegjësve të Departamenteve në udhëzimin e stafit akademik, për mënyrën e hartimit të tezës në përputhshmëri me kohëzgjatjen e provimit 1 orë dhe përqindjes në pikë të notës përfundimtare;
6. Ngarkimin e Administratorit, Drejtorisë së Shërbimeve në marrjen e masave për matjen e temperaturës, higjienizimin e godinave, ajrosjen e vazhdueshme të auditorëve, si dhe orientimin e studentëve për hyrjet daljet në godinat përkatëse.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Zv. Rektorët
 - Administratori
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtuesit e Njësive Bazë
 - Drejtorët e Drejtorive

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Prof. Dr. Ksenaq SOTIROFSKI

